

### LËNDA ARKIVORE PËRMES MJETEVE TË KËRKIMIT: PËRGATITJA E *INSTRUMENTA STUDIORUM* SI FORMË EVIDENTIMI, SHËRBIMI DHE PËRMBUSHJEJE E DETYRIMEVE LIGJORE TË ARKIVAVE. RASTI I ARKIVIT QENDROR SHQIPTAR.

“E shkuara është prologu”. Me këto fjalë fillon një nga artikujt e konsideruar klasikë në lëmin e shkencës arkivore, me autor Terry Cook<sup>1</sup>. Parë me syrin e shek. XXI, puna arkivore e shekujve të mëparshëm është vetëm një parathënie e epokës së re të arkivave të numerizuar. Megjithatë, guri i themelit në organizimin e punës arkivore mbetet, gjithmonë, gjithçka e bërë nga një çast fillestar në të shkuarën, deri sot. Brenda po kësaj logjike, puna arkivore në Arkivin Qendror Shtetëror të Shqipërisë mbetet, ngahera, e varur dhe e “vulosur” prej punës së kryer më parë, që nga themelimi i institucionit, deri sot. Në artikullin e mësipërm, Cook citon Barbara Craig, pedagoge e arkivistikës, e cila thotë: “[...] kur nuk ekziston e shkuara dhe mungon arsyeja për të parë me krenari të shkuarën, atëherë nuk ka as të ardhme, as shpresë”. Në vijim të po këtij shqetësimi profesional, në këtë artikull do të trajtojmë problemin e *instrumenta studiorum*, ose, siç e përdorim tashmë në metodat e punës apo në aktet nënligjore në shqip, aparatit tekniko-shkencor. Do të përqipemi të ndërtojmë një historik të përgjithshëm të punës me aparatit tekniko-shkencor të AQSh, një vlerësim për punën e kryer në ndërtimin e këtij aparati, si dhe do të sugjerojmë disa shtesa apo ndryshime, të cilat i konsiderojmë të domosdoshme për funksionimin e plotë të AQSh dhe zbatimin e detyrimeve ligjore.

Historiku i arkivave në Shqipëri mund të jetë i hershëm, por puna arkivore e organizuar dhe sistematike fillon, sipas mendimit tonë, vetëm me themelimin e Arkivit të Shtetit më 1949, i cili u formua si sektor i bashkangjitur i Institutit të Shkencave.<sup>2</sup> Më 1951 Arkivi i Shtetit u vendos nën varësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme<sup>3</sup>, kurse më 1955 krijohet, paralelisht, Drejtoria e Arkivave, e cila kishte në varësi Arkivin Qendror Shtetëror Historik dhe Arkivin Qendror Shtetëror<sup>4</sup>. Detyra e këtij të fundit ishte mbledhja, përpunimi dhe shërbimi i dokumenteve administrative të pas Luftës II Botërore, teksa Arkivi i Shtetit, i ardhur nga varësia e Insitutit të Shkencave, u kthye në Arkivin Qendror Shtetëror Historik, dhe kishte detyrë të përpunonte dhe të shërbente lëndën

<sup>1</sup> Terry Cook, “What is past is prologue: a history of archival ideas since 1898, and the future paradigm shift.” *Archivaria* 43 (1997), fq. 17-63.

<sup>2</sup> AQSh, F. 507, V. 1949, D. 1.

<sup>3</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, dt. 18.VI.1951 “Mbi krijimin dhe organizimin pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Arkivit Shtetit”. AQSh, F. 507, V. 1951, D. 1, fl. 1, 2.

<sup>4</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 210, dt. 31.V.1955, AQSh, F. 507, V. 1955, D. 1.

arkivore me karakter historik të para LIIB. Më 1963, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave kaloi nën varësi të Këshillit të Ministrave, varësi e cila vijon deri më sot.<sup>5</sup> Ndërkohë, Arkivi Qendror Shtetëror dhe Arkivi Qendror Shtetëror Historik u shkrinë bashkë, meqenëse puna arkivore mbetej e përbashkët dhe, nga ana administrative, ndodheshin nën të njëjtën Drejtori.

Duke pasur parasysh fazat historike të institucionit arkivor në Shqipëri, mund të ndajmë edhe historinë e punës arkivore në dy periudha: 1) 1949 – 1962 dhe 2) 1963 deri më sot. Gjatë periudhës së parë shohim një përpjekje për të hedhur bazat kryesore të sistemit të lëndës arkivore. Kjo fazë korrespondon me ndërtimin e fondeve (serive të dokumenteve), dhe krijimin e njësisve të ruajtjeve (dosjeve). Në periudhën e dytë, 1963 e më pas, tekta vazhdon procesi i mësipërm, fillon të zbatohet dhe krijimi i aparatit tekniko-shkencor, i cili (duke lënë mënjanë inventarin e fondit) ndahet në:

1. skedarë,
2. katalog sistematik,
3. skedar sistematik,
4. katalog tematik,
5. katalog gjeografik,
6. katalog emëror,
7. katalog lëndor,
8. udhërrëfyesve (të ndryshëm),
9. historik i fondkrijuesit,
10. historik i fondit.

Sigurisht, arkivistët dhe kush ka shpenzuar pak kohë duke studiuar në AQSh do të kuptojë se jo të gjitha këto mjete të aparatit tekniko-shkencor ekzistojnë. Përvoja na tregon se mungon historiku i fondkrijuesit dhe e historiku i fondit. Pikërisht këtu fillon qëndrimi ynë kritik lidhur me *instrumenta studiorum* të AQSh.

Sipas manualit më gjithëpërfshirës të punës arkivore në rrjetin arkivor kombëtar, *Praktika arkivore në Shqipëri*, me autor arkivistin e vjetër Mihallaq Pela<sup>6</sup>, aparati tekniko-shkencor duhet të përbëhet nga zërat e mësipërm. Në manual jepen, po ashtu, edhe udhëzime të përgjithshme të mënyrës si krijohet një aparat i tillë. Si rrjedhojë, sot kemi, veç inventarëve të fondeve, katalogë të ndryshëm sistematikë, skedarë të periudhave të ndryshme historike, skedarë emërorë, katalogë tematikë dhe tregues toponimik dhe antroponimik bashkangjitur katalogëve. Këto mjete kërkimi mbulojnë vetëm një periudhë të pjesshme të lëndës arkivore të AQSh, pasi edhe data e fundit kur është punuar me një syresh është shumë vite larg nga sot, pasi këto instrumente kanë reshtur së krijuari në mes të viteve 1990. Kjo është e para e metë e këtyre mjeteve të kërkimit, pasi shtesat e fondeve, të cilat vazhdojnë t'u bashkangjiten edhe sot fondeve

<sup>5</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, dt. 24.I.1963, AQSh, F. 507, V. 1963, D. 7.

<sup>6</sup> Mihallaq Pela, *Praktika arkivore në Shqipëri*, Tiranë 2003.

ekzistuese, apo çelja e fondeve të reja, nuk pasqyrohet dhe as mundet të shtohet në këto mjete kërkimi, për shkak të rendit kronologjik që ndjekin ato.

Një tjetër problem që hapet është metoda e punës e përdorur për periudha të ndryshme historike. Katalogu Sistematik ndahet në dy pjesë: 1. Periudha nga shek. VI – 1831; 2. Periudha 1832 – 1912. Katalogu i periudhës së parë është një dhe ndjek rend kronologjik të pasqyrimin të dokumenteve. Në fund është pajisur edhe me tregues antropomik, toponimik dhe të *realia* (sendeve). Kurse katalogu i periudhës 1832-1912 është i ndarë në këto degë veprimtarie: a) Shteti dhe e drejta; b) Ekonomia; c) Arsim-Kulturë-Shkencë; d) Kleri; e) Politika. Një ndarje e tillë nuk është *a priori* e kritikueshme, por sepse krijon mungesë ekuilibri në vëmendjen që tregon arkivi për dokumentet që ruan, të cilat ka detyrë edhe t'i shërbejë. Periudhës 1832-1912 i korrespondojnë edhe shumë prej fondeve personale të rilindasve, prandaj dhe është e mbuluar më mirë me mjete kërkimi. Kurse periudha nga shek. VI-1831, megjithëse më pak e përfaqësuar me dokumente, ka vetëm dy mjete kërkimi, inventarin e çdo fondi dhe katalogun sistematik. Dokumentet e shek. VI-XVII i përkasin, së shumti, Koleksionit të Kodikëve, dhe nuk flasin drejtpërdrejt për historinë në përgjithësi. Ndërkaq, pjesa tjetër e dokumenteve të këtij grupimi dokumentesh, që përputhet me periudhën e Perandorisë Osmane, lidhet pikërisht me një periudhë relativisht pak të studiuar të historisë së Shqipërisë, prandaj një shërbim i dobët arkivor vetvetiu sjell si pasojë dekurajimin e studiuesve dhe pengimin e tyre në punën kërkimore.

Duke iu afruar kohës së sotshme, mjetet e kërkimit bëhen më të rafinuara. Për periudhat 1913 – 1944, dhe 1945 – 1990 (e quajtur “Periudha e Socializmit”), janë hartuar skedarët përkatës sistematikë. Të dy këta skedarë janë një ndihmë aspak për t'u shpërfilluar në dobi të studimit, pasi mundësojnë kërkim të kryqëzuar të informacionit. Mirëpo, nuk mungojnë të metat, po aq të mëdha sa edhe dobia. Citoj Kryetaren e Degës së Përpunimit, Eleni Duka: “për periudhën 1913-1944 skema e katalogut sistematik nuk është e plotë, ka nevojë të pësohet, dhe skedimi është bërë kryesisht mbi bazën e titujve të dosjeve (pra: nuk është marrë parasysh përmbajtja e dokumentit, e cila jo gjithmonë përputhet me titullin e dosjes, S.Ç.), prandaj ky skedar nuk kënaq shumë kërkesat e shfrytëzimit”.<sup>7</sup> Këtë kritikë Eleni Duka e bën në nëntor të vitit 1985. Të njëjtat probleme janë aktuale edhe sot.

Skedari emëror është një tjetër mjet kërkimi, i cili shtrihet në të gjithë lëndën e AQSh. Ndoshta është i vetmi mjet kërkimi që e udhëzon studiuesin drejtpërdrejt në temën e kërkuar, për shkak të rubrikave të shumta që përmban skeda. Sidoqoftë, nuk mungojnë të metat në hartimin e skedave emërore. Duke perifrastuar një relacion të vitit 1993 të arkivistes së atëhershme, Nevila Nika, të metat e skedarit emëror lidhen me: mënyrën e konceptimit të skedës dhe

<sup>7</sup> Eleni Duka, “Studim mbi mangësitë e konstatuara në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve dhe rrugët për ndreqjen e tyre”, AQSh, F. 507, V. 1985, D. 37, fl. 4-13.

mënyrën e renditjes, mosrespektimin e të gjitha të dhënave të skedës (nr. i Fondit, citimit të vitit të dosjes, viti i dokumentit), njohuritë jo të mira të arkivistikës apo historisë të arkivistëve që kanë përgatitur skedat.<sup>8</sup> Në po të njëjtin raport, N. Nika propozon hartimin e një skedari të përgjithshëm emëror dhe më të hollësishëm për çdo emër që paraqitet në çdo dokument të AQSh, si korigjim i drejtpërdrejtë i të metave të aparatit tekniko-shkencor. Ky propozim u miratua nga drejtorja e kohës, por kurrë nuk është vënë në zbatim.

Përgjegjësitë për papërsosmëritë e mjeteve të kërkimit në AQSh janë të shumëanshme. Në njërën anë qëndrojnë idealet e kohës në të cilën është kryer puna arkivore, e cila nuk konsideronte të rëndësishme për t'u evidentuar një sërë veprimtarish dhe personash ideologjikisht kundër sistemit totalitar. Ideologjia moniste duket qartë në çdo ligj, urdhër, udhëzim. Nga ana tjetër pengesë kanë qenë shkaqet njerëzore, si mungesa e përvojës, moskryerja e të gjitha proceseve të punës në vijimësi, niveli i ulët profesional dhe kulturor i punonjësve (duke cituar Eleni Dukën në studimin e sipërpërmendur).

Rezultatet pozitive të këtyre mjeteve të kërkimit janë lehtësisht të evidentueshme sa herë që një dokument i AQSh citohet në një studim. Ndërsa mes pasojave negative do të renditeshin:

- kaos në infomimin e publikut
- humbje kohe për konsultimin e dokumenteve
- mosevidentim i dokumentit
- amortizim i formatit të mjeteve të dokumentit (riprodhimin) apo, më keq, origjinalit.

Lista mund të jetë e gjatë. Teksa puna arkivore është tashmë shumë prapa në krahasim me kohën në të cilën jetojmë, metodat e punës duhet të ndryshojnë dhe të përshtaten me përvojën botërore, duke respektuar, aq sa ka vend, traditat lokale. Duke shfletuar proces-verbalet e mbledhjeve të DPA që nga themelimi, deri më sot, arkivistët japin sugjerime profesionale dhe të qarta, është e lehtë të gjenden dhe të merren në konsideratë. Shkurtimisht në këtë kumtesë do të shprehja disa sugjerime për skedarin tematik.

Teksa disa rubrika të Skemës së Klasifikimit logjika praktike thotë se nuk duhet të përfshihen në të, siç është, p.sh., rubrika “Veprimtaria antikombëtare e bajraktarëve dhe reaksionit”, tematika të tjera, që do të ishin po kaq të logjikshme, nuk janë përfshirë. Si, p.sh.:

- Patriarkalizmi;
- Dhuna në familje;
- Vetëidentifikimi gjinor / homoseksualiteti (queer theory);
- Diferencimi gjinor;
- Diferencimi racor (nuk janë të pazakonta etiketimet “jevq / evgjit”,

<sup>8</sup> Nevila Nika, “Relacion mbi gjendjen e skedave emërore dhe rrugët e përmirësimit të mëtejshme të tyre”, AQSh, F. 507, V. 1993, D. 12.

- “gabel”, “cigan” në burimet dokumentare);
- Devijimet / perversitetet seksuale (vuajerizmi, pedofilia, fetishizmi, nekrofilia, etj.);
  - Revolucioni kinez / krijimi i Njeriut të Ri Socialist;
  - Heronjë (viktimat?) e punës socialiste.

Duke perifrastuar Angelika Menne-Haritz<sup>9</sup>, arkivi që tregon vëmendje më shumë për ruajtjen, sesa për shërbimin e dokumenteve, i krijon vetes disavantazhe në shoqërinë e sotshme të periudhës së internetit. Në fillim, arkivi e zhvendos veten në të shkuarën ose në të ardhmen, duke harruar të jetë i pranishëm në të tashmen. Edhe kur arkivi kërkon të tregojë praninë e tij në të sotshmen përmes marketingut apo ekspozitave, përsëri, nuk ka kapacitet për të konkurruar institucionet e specializuara shkencore apo universitare, dhe është i destinuar të mbetet në hije. Që arkivi të jetë i pranishëm në të sotshmen e shoqërisë së cilës i shërben, duhet të përmbushë detyrën e shërbimit të dokumenteve dhe të sigurojë mjetet e aksesit të publikut tek dokumenti. Arkivi nuk jep përgjigje, nuk jep informacion të mirëfilltë, por ofron informacion potencial për cilindo që ka qëllim të kuptojë arkivin dhe dokumentin. Ky është ndryshimi mes arkivit të mbyllur dhe arkivit të hapur: arkivi i mbyllur mbledh dokumentet e së shkuarës dhe i ruan për të ardhmen; arkivi i hapur ofron mjete kërkimore në të tashmen, i jep sot akses studiuesit të zbulojë informacion nga dokumentet arkivore.

Mes ngjyimeve të shumta që ka e shkuara, ka mes tyre dhe arsye për t'u mburrur. Megjithatë, për të mos mbetur vetëm në fazën e prologut, 43 vjet pas manualit të parë të arkivistikës *Puna arkivore në Shqipëri*, ka ardhur koha që të tjera manuale dhe të tjera metoda pune të përdoren në rrjetin arkivor kombëtar, jo vetëm duke pasur parasysh metodat tradicionale hard-copy, por mjetet e kërkimit dhe të informimit të numerizuar dhe në distancë. Shërbimi i lëndës arkivore nuk është thjesht privilegj i arkivave, por është detyrim shoqëror dhe ligjor i tyre.

---

<sup>9</sup> Angelika Menne-Haritz, “Acces – The reformulation of an archival paradigm”, në *Archival Science* 1 (2001), 57-82.

## **Bibliografi:**

### *Bibliografi parësore:*

AQSh, F. 507, V. 1949, D. 1.

AQSh, F. 507, V. 1951, D. 1, fl. 1, 2. (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, dt. 18.VI.1951 “Mbi krijimin dhe organizimin pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Arkivit Shtetit”.)

AQSh, F. 507, V. 1963, D. 7. (Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, dt. 24.I.1963).

AQSh, F. 507, V. 1985, D. 37, fl. 4-13 (Eleni Duka: “Studim mbi mangësitë e konstatuara në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve dhe rrugët për ndreqjen e tyre”.)

AQSh, F. 507, V. 1993, D. 12. (Nevila Nika: “Relacion mbi gjendjen e skedave emërore dhe rrugët e përmirësimit të mëtejshme të tyre”.)

### *Bibliografi dytësore:*

Angelika Menne-Haritz, “Acces – The reformulation of an archival paradigm”, në *Archival Science* 1 (2001).

Mihallaq Pela, *Praktika arkivore në Shqipëri*, Tiranë 2003.

Terry Cook, “What is past is prologue: a history of archival ideas since 1898, and the future paradigm shift.” *Archivaria* 43 (1997), fq. 17-63.